

**Shoqeria "Horasoft" shpk**

Nipt M01317012Q

Adresa: Tirana Business Park, Rruga Rinas, Ndertesa 07 Hapesira Co.working, kati 01 Vore,  
Tirane 1036

VENDIM I ORTAKEVE  
TE SHOQERISE "Horasoft ne likujdim" SHPK  
Nr.3 Date 18.03.2021

Sot me daten 18.03.2021, u mblodh asambleja e ortakeve te shoqerise "HORASOFT ne likujdim" Shpk e perbere nga,

Z.Fatjon Seitaj, ortak me 50% te kuotave te kapitalit

Z.Herald Meta , ortak me 50% te kuotave te kapitalit

**Rendi i dites se mbledhjes.** Shqyrtimi i raportit te likujdatorit per likujdimin perfundimtar te shoqerise.

Sipas raportit te likujdimit, jane zbatuar te gjitha procedurat e ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" i ndryshuar, eshte miratuar faza e pare nga QKB duke pranuar vendimin e ortakeve per te kaluar ne likujdim kete shoqeri.

Asambleja e pasi analizoi raportin e likujdimit, te pergatitur nga likujdatori i shoqerise, z. Fatjon Seitaj, per likujdimin e saj, faktin qe shoqeria ka pergatitur bilancet financiare te fillimit te likujdimit, sipas vendimit te asamblese nr.1 date 16.02.2021,ka pergatitur edhe bilancin e perfundimit te likujdimit date 18.03.2021. Shoqeria nuk ka kryer veprimtari per periudhen e likujdimit, perjashtur disa shpenzime te kryera per veprimtarine e likujdatorit per pagat, sigurimet shoqerore dhe taksat dhe tarifat vendore per vitin 2020-2021.

Jane hartuar bilancet kontable te fillimit te likujdimit dhe ai i likujdimit perfundimtar dhe shoqeria nuk ka asnje detyrim ndaj te treteve.

Ortaket duke analizuar te gjithë punen e bere nga likujdatori i shoqerise

KONSTATUAN

Jane zbatuar te gjitha procedurat ligjore per mbylljen me likujdim te shoqerise "HORASOFT" shpk. Ne keto kushte ortakët e shoqerise;

VENDOSEN



1. Te miratojne raportin e likujdimit nga ana e likuidatorit z. Fatjon Seitaj per mbylljen perfundimtare te shoqerise.
2. Te miratoj bilancet e fillimit dhe perfundimit te likujdimit te paraqitur nga likujdatori z. Fatjon Seitaj
3. Te likujdohet perfundimisht shoqeria "HORASOFT ne likujdim" shpk
4. Te depozitohet ky vendim ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe Drejtorine Rajonale Tatimore, Tirane.

ORTAKET E SHOQERISE  
"HORASOFT ne likujdim " SHPK

Fatjon Seitaj



Herald Meta

